



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:255843

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05655007

KF.nr.104/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me Procesmbajtëse Arlinda Hyseni në kontestin tregtar administrativ të paditësit “MS Medicom” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson avokatura “Ramaj & Palushi” LLC, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, në rigjykim-rivendosje sipas Aktvendimit K.Dh.Sh.II.nr.666/22 të datës 14.02.2024, të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlera e kontestit 69,292.54 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Avokat Kushtrim Palushi nga avokatura “Ramaj & Palushi” LLC, e në mungesë të palës së paditur, me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “MS Medicom” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Avokat Kushtrim Palushi, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.453/2018, i datës 20.11.2018, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Dhoma e shkallës së dytë të kësaj gjykate me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr.666/22 të datës 14.02.2024, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, e ka prishë Aktgjykimin A.nr.2966/18 të datës 10.02.2021 dhe lëndën e ka kthyer kësaj gjykate në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi “MS Medicom” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 18.12.2018, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr.453/2018, i datës 20.11.2018 kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke propozuar që të aprovohet padia e paditësit, të anulohet vendimi i ATK-së nr.453/2018, i datës 20.11.2018, dhe të obligohet ATK që të bëjë kthimin e mjeteve të inkasuar për Tatim Mbi Vlerën e Shtuar pa bazë ligjore në shumë të përgjithshme prej 69,292.54 euro. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se: Deri tek vendimi i te paditurës është ardhur pas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje administrative me nr.A.nr.1058/15 të datës 11.09.2018 me te cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe me te cilin gjykata kishte konstatuar se bazuar ne nenin 27 te Ligjit 03/L-146 për TVSH ishte parapare se transaksionet lidhur me shërbimet spitalore, kujdesi mjekësor dhe aktivitetet e lidhura ngushte me to janë transaksione te liruar si dhe furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, instrumenteve dhe aparaturave mjekësore dhe kirurgjike. Ky aktgjykim i gjykatës ishte bërë i plotë fuqishëm me datën 03.12.2018 për shkak qe e paditura nuk kishte ushtruar ankese ndaj te njëjtit. Për kundër se interpretimi i gjykatës dhe aktgjykimi si i tille kane qene te qartë e paditura ne rivendosje përsëri vendos njëjtë sikurse ne vendimin e parë te kontestuar. Përkundër vendimit te gjykatës së shkallës së dytë të gjykatës komerciale me te cilin ankesa e të paditurës është aprovuar si e bazuar, konsiderojmë se çështja ligjore lidhur me këtë padi është tashme çështje e gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm te Gjykatës Themelore ne Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, Aktgjykimi A.nr.1058/15 i datës 11.09.2018 andaj çdo gjykim ndryshe do te përbënte prishje te këtij aktgjykimi e cila nuk është e lejuar me rregullat e procedurës kontestimore mbi çështjen e gjykuar. Megjithatë për te hequr dilemat e kësaj gjykate se a kane qenë shërbimet e ofruara nga paditësi, shërbimet te liruar sipas nenit 27 te Ligjit për TVSH, paditësi ofron edhe sqarimet plotësuese ne vijim, pajisjet te cilat janë te servisuara nga paditësi janë pajisje te anestezionit dhe si te tilla janë kruciale dhe tejet te rëndësishme për mbajtjen e pacientit ne jete gjate kohës sa te njëjtit i nënshtrohet procedurave kirurgjikale. Pajisjet e tilla konsiderohen si pjese kyçe te pajisjeve në të cilat zhvillohen shërbimi spitalor gjegjësisht pa te njëjtat nuk mund te ndërmerren asnjë veprim në mbrojtje apo shpëtimin e jetës së pacientit. Në gjykimin e çështjes për herën e dytë paditësit kishte dorëzuar një parashtresë me prova shtesë me te cilat vërtetohen se shërbimet e tilla gjate periudhave te ndryshme me herët, derisa ka qenë ne fuqi ligji për TVSH janë trajtuar si shërbime te liruar për të cilat nuk është ngarkuar TVSH. Fakti qe këto shërbime kane qenë te liruar me herët vërtetohet edhe nga ndryshimi i ligjit për TVSH i cili nga viti 2017 e tutje këto shërbime i ka paraparë specifikisht si shërbime për të cilat

duhet të ngarkohet TVSH. Kërkoj nga Gjykata që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si te bazuar, të anuloj vendimin 453/2018 te datës 20.12.2018 dhe te obligoj te paditurën qe paditësit MS Medicom- Prishtine t 'ia kthej mjetet e paguara ne emër te TVSH-ës për periudhën kontestuese 01/07 deri me 12/2011 në vlerë prej 69,292.54 euro me kamate ligjore prej 8% nga data e paraqitjes se padisë se parë me 11.06.2015. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 11.12.2019, ka theksuar se padia-ankesa nuk është e bazuar në prova materiale dhe fakte të bazuara. Vendimi i Departamentit të Ankesave nr.453/2018 datës 20.11.2018 është i drejtë dhe në pajtim me legjislacionin tatimor të aplikueshëm. Ka shtuar se sipas Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar neni 27 specifikon lirimet për aktivitete e caktuara me interes publik, neni 27 par.1.2 *“Ofrimi i kujdesit mjekësor në ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe para mjekësore sikur që janë përkufizuar me ligjet e Kosovës në fuqi dhe furnizimi i barnave produkteve farmaceutike, instrumenteve dhe aparaturave mjekësore dhe kirurgjike”* pra nga kjo shihet se për shërbimet e mirëmbajtjes dhe sevisimit të aparaturave mjekësore, nuk janë të paraparë lirimet nga TVSH-ja po ashtu nuk janë të përmendura as në ligjet tjera tatimore. Ndërsa në UA 10/2010, neni 16 përcakton *“Kur qëllimi kryesor nuk e ka për synim mbrojtjen, mirëmbajtjen ose shërimin e shëndetit të personit të caktuar, furnizimi nuk lirohet si shembull mund të jenë shërbimet kozmetike ose estetike”*. *“Kur qëllimi kryesor i shërbimit është t'i ofroj palës së tretë elementin e nevojshëm për marrjen e vendimit, ky furnizim nuk i nënshtrohet lirimit”*, Pra dispozitat ligjore nuk e kanë specifikuar shërbimet e mirëmbajtjes dhe sevisimit të aparaturave mjekësore, që nënkupton të kundërtën të paditësve, do të thotë se ato nuk janë liruar. Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditur e ka pranuar ftesën për këtë seancë me datë 26.03.2024, ndërsa me parashtesën e datës 19.04.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veprojnë në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së. Gjykatës i ka propozuar ta refuzoj padinë/ankesën e paditësit si të pabazuar dhe ta lë në fuqi vendimin nr.453/2018 datës 20.11.2018 i ATK-së. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 29.04.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi 453/2018 i datës 20.11.2018, Aktgjykimi 1058/15 i datës 11.09.2014, Vërtetimi tatimor i datës 11.12.2018, Kërkesa për kompensimin e debi-kredive, Raporti i kontrollit i datës 23.02.2015, Kontratat për mirëmbajtjen e aparaturave nr.206/11/018/211, Raporti i kontrollit i datës

21.12.2016, Kontrata pjesë B e datës 22.09.2010, 29.10.2009, 24.08.2009, 06.02.2008, 12.08.2008 dhe 27.12.2006, Libri i shitjes për vitet 2008-2011, Faturat nr.006/07, 007/07, 011/07, 012/07, 016/07, 018/07, 003/08, 006/08, 008/08, 010/08, 011/08, 012/08, 004/09, 008/09, 011/09, 017/09, 018/09, 021/09, 023/09, 025/09, 030/09, 031/09, 035/09, 036/09, 037/09, 038/09, 039/09, 008/10, 010/10, 012/10, 014/10, 016/10, 022/10, 031/10, 032/10, 014/11, 015/11, 016/11, 017/11, 018/11, 019/11, 020/11, 028/11, 032/11, 033/11, 034/11, 035/11, 036/11, 038/11, 046/11, 050/11, Përgjigja në padi e datës 11.12.2019, Vendimi 93/2015 i datës 18.05.2015, Sqarim për TVSH nr.17/2014 i datës 16.09.2014, 06/2015 i datës 12.03.2015, 93/2015 i datës 14.04.2015, dhe 02/2014 i datës 08.01.2014.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve të padi, shkresat e lëndë aktvendimit kontestues dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi pas pranimit të Raportit të kontrollit të datës 23/02/2015 ka parashtruar ankesë, pran Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, për të cilën ankesë ATK me datë 18.05.2015 ka sjell vendimin nr.93/2015, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 18.12.2018, ka iniciuar konflikt administrativ ku Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me aktgjykimin A.nr.1058/15 të datës 11.09.2018 e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe në rivendosje, Administrata Tatimore e Kosovës Departamenti i Ankesave me datë 20.11.2018 ka sjell vendimin nr.453/2018 me të cilën e ka refuzuar si të pa bazë ankesën në ri procedure të subjektit "MS Medicom" Sh.P.K., paditësi si i pakënaqur këtë këtë vendim e ka kundërshtuar, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal me aktgjykimin A.nr.2966/18 të datës 10.02.2021, ka sjell aktgjykim me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar vendimin nr.453/2018 i datës 20.11.2018, kundër të cilit aktgjykim e paditura Administrata Tatimore e Kosovës ka parashtruar ankesë me datë 15.04.2021.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ka marrë aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr.666/22 të datës 14.02.2024, me të cilin e ka aprovuar të njëjtën, dhe e ka prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2966/18 të datës 10.02.2021, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, me rekomandim se gjykata e shkallës së parë në ri procedurë duhet të vërtetoj saktë gjendjen faktike, të bëjë administrimin dhe vlerësimin e të gjitha provave materiale veç e veç dhe në mënyrë të tërësishme, duke vlerësuar nëse aktiviteti për të cilin paditësi i është nënshtruar TVSH hyn në grupin e kategorive të liruara nga TVSH dhe më pas në mënyrë të drejtë të zbatoj të drejtën materiale, në vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrë së vendimit të paditurës gjatë procedurë administrative, konform nenit 43 par.1 dhe 2 të LKA-së.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave - të ATK-së, me vendimin kontestues nr.453/2018 të datës 20.11.2018 e ka refuzuar si të pa bazë ankesën në ri-procedurë me arsyetim se duke u bazuar në analizën e shkresave zyrtare rreth sqarimit për TVSH “Shërbimet e servisimit, mirëmbajtjes etj., të instrumenteve dhe të aparaturave mjekësore dhe kirurgjie nga aspekti i Ligjit për TVSH nr.03/L-146”, sipas të cilit sqarohet baza ligjore neni 27 Lirimi për aktivitet e caktuar për interes publik, ku transaksionet janë të liruara si në vijim: *1.2 ofrimi i kujdesit mjekësor në ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe para mjekësore sikur që janë përkufizuar me ligjet e Kosovës në fuqi dhe furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, Instrumenteve dhe aparaturave mjekësore dhe kirurgjike.* Tutje ka theksuar se nga baza ligjore e lart e cituar të paragrafit 1.2 neni 27 të Ligjit për TVSH-ë nr,03.L-146, nënkuptohet se vetëm furnizimi (shitja) e instrumenteve dhe aparaturave mjekësore dhe furnizime të liruara pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme. Kurse për shërbimet e mirëmbajtjes, servisimit etj., të këtyre aparaturave dhe instrumenteve mjekësore dhe kirurgjike, nuk janë paraparë lirimet nga TVSH-ja sipas këtij paragrafi të lartë përmendur, apo edhe nga ndonjë dispozitë tjetër sipas Ligjit për TVSH-ë nr.03/L-146 dhe Ligjit nr.04/L-108 ku theksohet se *“Shërbimet e mirëmbajtjes, servisimit etj., të instrumenteve dhe aparaturave mjekësore dhe kirurgjike janë furnizime të tatueshme me normën standarde të TVSH-së me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshëm sipas nenit 36 të Ligjit nr.03L-146”*

Gjykata vlerëson si të pa bazuar pretendimin e paditësit se servisimi dhe mirëmbajtje e aparaturave të anestezionit është në tërësi brenda kuadrit të transaksioneve të liruara nga TVSH,

për arsye se këto shërbimet e servisimit të mirëmbajtjes nuk hynë në kuadër të furnizimit të instrumenteve ose aparaturave mjekësore, po ashtu këto shërbime nuk përfshihen nga shërbimi shëndetësor i cili është i parapara në nenin 27 të Ligjit për TVSH, ku thekson lirimet për aktivitete e caktuara me interes publik ku Transaksionet janë të liruara si në vijm: *“Ofrimi i kujdesit mjekësor në ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe para mjekësore sikur që janë përkufizuar me ligjet e Kosovës dhe po ashtu furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, Instrumenteve dhe aparaturave mjekësore kirurgjike”* kjo nënkupton se vetëm furnizimi i instrumenteve, aparaturave mjekësore dhe kirurgjikale janë të liruar pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme, ndërsa shërbimet e mirëmbajtjes dhe servisimit të këtyre aparaturave dhe instrumenteve mjekësore dhe kirurgjike, nuk janë paraparë lirimet nga TVSH-ë, nr.03L-146 dhe Ligjit nr.04 L-108 do të thotë se *“Shërbimet e mirëmbajtjes, servisimit etj., të instrumenteve dhe aparaturave mjekësore dhe kirurgjike janë furnizime të tatueshme me normën standarde të TVSH-së me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme”* sipas nenit 36 të Ligjit nr.03/L-146, gjithashtu këto pajisje kanë qenë nën garancion dhe servisimit i tyre ka ndodhur në Kosovës dhe jo jashtë Kosovës. Sa i përket pretendimit të paditësit se Aktgjykimi A.nr.1058/15 i datës 11.09.2018 është bërë i plotfuqishëm dhe konsiderohet se çështja ligjore lidhur me këtë padi është çështje e gjykuar, gjykata e vlerëson edhe këtë pretendim si të pabazuar për arsye se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykim A.nr.1058/15 i datës 11.09.2018 nuk ka vendosur për çështjen në mënyrë meritore por lëndë e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura Administrata Tatimore e Kosovës.

Duke marrë për bazë faktin se gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 1, të LKA-se, nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur, kjo për faktin se paditësi në këtë kontest tregtar-administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në

vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar-administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Ndërsa me nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike gjykata vlerëson se vendimi nr.453/2018, i datës 20.11.2018 i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të neni 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.104/24 datë 29.04.2024

Procesmbajtëse
Arlinda HYSENI

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.